

**NDIKIMI I MODELIT NANSEN PËR ARSIM INTERKULTUROR
NË SHKOLLËN FILLORE “GOCE DELLÇEV”, GOSTIVAR,
REPUBLIKA E MAQEDONISË**



Raport nga hulumtim i realizuar nga

Dr Anne Murray
DipEd, D.A.S.E, Mr. (Ed.Man), Mr. (Ed.Tech.), Ed.D

5 Mars, 2018

NDIKIMI I MODELIT NANSEN PËR ARSIM INTERKULTUROR NË SHKOLLËN FILLORE “GOCE DELÇEV”, NË GOSTIVAR, REPUBLIKA E MAQEDONISË

HYRJE

Koncepti për arsim interkulturore është zhvilluar nga një grup ekspertësh i themeluar nga Qendra Nansen për Dialog në Shkup në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë. Që nga viti 2016, Qendra Nansen për Dialog ekipi (NDC) në Shkup, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, është fokusuar në zbatimin e modelit të propozuar për arsim interkulturore në shtatë shkolla model të përzgjedhura me një profil multietnik të nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve.”

Në pranverë të vitit 2017, u realizua një hulumtim në këto shkolla të përzgjedhura, për të vlerësuar nivelet e ndryshme të bashkëpunimit midis nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve me prejardhje të ndryshme etnike si brenda ashtu dhe jashtë shkollave. Mostra përbëhej nga nxënës, mësues dhe prindër të cilët nuk ishin përfshirë në Modelin Nansen për Arsim Interkulturore (NMIE).”

Ky hulumtim aktual i vitit 2018 është autorizuar nga Qendra për Dialog Nansen për të bërë një vlerësim në një shkollë model, shkollën fillore “Goce Dellçev” në Gostivar, të mësimitdhënësve dhe nxënësve (dhe prindërve të tyre), të cilët kanë qenë pjesë e modelit Nansen për tre vitet e kaluara. Kjo u bë për të vlerësuar nëse dhe në çfarë kanë ndryshuar mënyrë qëndrimit, vlerat dhe sjelljet e tyre në lidhje me elementet e interkulturore, sidomos në raport me nxënësit, prindërit dhe mësuesit, të cilët më parë nuk kanë pasur përvojë me këtë model.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Hulumtimi u realizua më 20 dhe 21 shkurt të vitit 2018, në shkollën fillore “Goce Dellçev”, Gostivar, ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe ose maqedonase gjatë dy ndërrimeve - për nxënësit shqiptarë në mëngjes dhe nxënësit maqedonas pasdite për dy javë, pastaj nxënësit maqedonas zhvendosen në mëngjes ndërkaq nxënësit shqiptarë pasdite, pra vepron sipas parimit të rotacionit. Koncepti Nansen për Edukimin Interkulturore u realizua pas përfundimit të ndërrimit në mëngjes dhe para fillimit të ndërrimit të pasdites, në mënyrë që të dyja grupet e nxënësve shqiptarë dhe maqedonas të mund të bashku të marrin pjesë në projekt.”

Objekt vlerësimi ishin tre grupe të nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve, të cilët ishin të përfshirë në projektin Nansen të realizuar përmes programeve jashtëshkollore gjatë tre viteve të fundit. Grupi i parë i 40 nxënësve tani janë në klasën VI. Ata morën pjesë në Projektin Nansen për tre vjet nga 2014/15 deri më 2016/17, por jo edhe gjatë vitit shkollor 2017/18. Grupi i dytë dhe i tretë, i përbërë nga 48 fëmijë tani në klasën IV dhe 45 fëmijë në klasën V, kanë marrë pjesë në modelin Nansen për dy vite të plota, që nga vjeshta e vitit 2015.”

Të dhënat kualitative janë mbledhur, regjistruar dhe analizuar nga nxënësit, mësuesit, prindërit dhe ekipi i drejtorisë së shkollës. Hulumtimi filloi ditën e parë duke intervistuar drejtorin dhe ekipin drejtues të shkollës. Më pas, vijuan dy vëzhgime të dy aktiviteteve të ndryshme jashtëshkollore, të cilat u mbajtën nga dy mësues tandem, një shqiptar dhe një maqedonas.

Më në fund, gjashtë mësues, të përbërë nga tre tandemë mësuesish, u intervistuan lidhur me përvojën e tyre deri tani. Dita e dytë filloi me intervistimin e 9 nxënësve shqiptarë, nxënës të klasave 4, 5 dhe 6, të cilët kishin qenë të përfshirë në modelin Nansen. Më pas vijuan dy vëzhgime paralele të dy aktiviteteve jashtëshkollore nga dy tandemë pioniere. Pastaj u zhvilluan intervista me 9 nxënës maqedonas nga klasat IV, V dhe VI. Një seancë përfundimtare intervistimi u mbajt me 18 prindër maqedonas dhe shqiptarë, fëmijët e të cilëve kishin përvojë me modelin Nansen për arsimin interkulturore”.

Hulumtimi gjithëpërfshirës dhe i shkëlqyer i vitit 2016, “Identifikimi i interkulturalizmit në shkollat multietnike në Republikën e Maqedonisë”, është marrë parasysh gjatë përgatitjes së pyetjeve dhe llojeve të fushave për hulumtim gjatë hulumtimit dhe vlerësimit të vitit 2018. Kjo ishte shumë e dobishme në kuptimin e kontekstit të shkollës fillore “Goce Dellçev”, si dhe shkollave tjera model. Pra hulumtimi ndihmoi në dhënien e një ideje në lidhje me llojet e vlerave, qëndrimeve dhe sjelljeve, në aspektin e elementeve ndëretnike dhe interkulturore që kanë mbizotëruar në kohën para përfshirjes së konceptit Nansenit në shkollë. Në këtë mënyrë, qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e tanishme mund të hulumtohen dhe të krahasohen për të përcaktuar përfitimet, ndikimin dhe impaktin që Nansen kishte pasur gjatë 3 viteve të fundit”.

Dokumenti i Konceptit për Edukim Interkulturore ishte shumë i rëndësishëm për të kuptuar esencën e modelit Nansen duke i përshkruar principet, objektivat dhe misionin e Edukimit Interkulturore, duke sqaruar kontekstin për arsim të integruar në Republikën e Maqedonisë.”

ANALIZA E REZULTATEVE TË HULUMTIMIT

Shënimet nga intervistat me drejtorin, ekipin drejtues, mësuesit, nxënësit dhe prindërit, si dhe shënimet nga seancat Nansen të mësimdhënies jashtëkurikulare u sistemuan në përputhje me shumicën e kategorive të hulumtimi të vitit 2016. Kuotat e drejtpërdrejta nga individët (të përkthyer) u regjistruan aty ku ishte e mundur për të dhënë një pasqyrë më të mirë mbi pikëpamjet, ndjenjat dhe mendimet e pjesëmarrësve për ndonjë impakt, përfitim ose ndikim të modelit Nansen në shkollën fillore “Goce Dellçev”. Këto shënime hulumtuese janë përshkruar më poshtë, të shoqëruara nga një përmbledhje e provave, konkluzionet finale dhe disa çështje për shqyrtim të ardhshëm.”

SHKOLLA FILLORE “GOCE DELLÇEV”: Përgjigjet e dhëna hulumtuesit

Përgjigjet e drejtorit dhe drejtorisë së shkollës

- Drejtori dhe zëvendësdrejtori kanë marrë vendim “të provojnë projektin”.
- Drejtori vuri në dukje: “Në fillim ishte e vështirë. Ishte më intensive me Nansen sesa me projekte të tjera. Me Nansen kishim aktivitet një herë në javë, për çdo javë.”
- Ai gjithashtu tha, “Disa mësues po më thoshin se ishte aq interesante për fëmijët sa që kërkonin të vinin përsëri në grup me fëmijët e tjerë. Ishte kënaqësi. Nëse nuk do t’u pëlqente, nuk mund t’i detyronit”.
- “Mësuesit janë të motivuar që të qëndrojnë më gjatë ... i gjithë qëndrimi i tyre ndaj shkollës ka ndryshuar”. Një nga ekipet tha se “I bashkon fëmijët, prindërit dhe mësuesit maqedonas dhe shqiptarë dhe krijon një atmosferë të ndryshme, një atmosferë pozitive”
- Të gjithë e vlerësuan mbështetjen nga Nansen në drejtim të trajnimit dhe ofrimit të materialeve.
- Një mësues tha se “pa drejtorin dhe ndihmësin, modeli Nansen ndoshta nuk do të ishte ky që është. Ndoshta do të shuhej.”
- Drejtori pranoi “Nuk ishte një shteg i qetë. Kishte vështirësi. Ne bëmë shumë përpjekje për ta bërë projektin të rritet.” Pastaj ai tha: “Tani kemi shumë partneritet të suksesshëm me Nansen.”
- Mësuesit ishin skeptikë në fillim. Ata mendonin se ishte vetëm edhe një projekt tjetër. Por gradualisht, “ata e kuptuan se kjo është diçka ndryshe, më e thellë, më serioze ... kryesisht mësuesit e pranojnë me kënaqësi. Dhe është jashtë kurikulimit kështu që fëmijët dhe mësuesit janë më të relaksuar ... Fëmijët dhe prindërit shohin se ka një atmosferë të re në shkollë.”
- Nansen furnizon me shumë mjete dhe këto mund të përdoren në klasa të tjera.
- Drejtori tha se në fillim, ishte e vështirë me disa mësues por gradualisht filloi të përhapet në shkollë në lëndë të tjera si arti dhe gjuhët. Një nga ekipi drejtues tha: “Unë nuk mendoja se do të arrinim kaq larg me projektin.”
- Një tjetër tha: “Ne ishim shkolla e parë. Tani mësuesit nga shkollat tjera dëshirojnë të mësojnë më shumë ... dhe shkolla nga e gjithë Maqedonia vijnë në shkollën tonë për të na parë.”
- Drejtori në përfundimin tha: Nëse më pyesin se cila ishte gjëja më e mire kam bërë, unë do të thosha se ishte modeli Nansen për arsimim të integruar.”

Përgjigjet lidhur me shoqërimin

- Drejtori beson se projekti Nansen ka ndikuar patjetër për të mirë në jetën e shkollës. Sa i përket nxënësve, ka më pak tension mes maqedonasve dhe shqiptarëve. Për shkak të mbështetjes së prindërve dhe përfshirjes në Nansen, ka më pak probleme me nxënësit.
- Nxënësit e intervistuar shqiptarë të gjithë deklaruan se kishin shokë maqedonas brenda dhe jashtë shkollës. Në shkollë ata shoqërohen me shokët e tyre maqedonas gjatë aktiviteteve interkulturore jashtë programeve mësimore sepse kjo është e vetmja kohë, kur ata takohen në shkollë për shkak të sistemit të ndërrimeve - nxënësit shqiptarë në ndërrimin e mëngjesit dhe ata maqedonas në pasdite. Nansen ka ndihmuar edhe shoqërimin: “para Nansenit kam dituar pak maqedonisht sepse kam një mik maqedonas, por përmes

- Nansen bëj sport jashtë shkollës me shokun e njohur nga Nansen”.
- Nxënësit thanë se prindërit e tyre i inkurajojnë të shoqërohen me maqedonasit – “ajo pëlqen që unë të flas me këdo që flet një gjuhë tjetër. “Mësuesit gjithashtu nxisin nxënësit të shoqërohen me “të tjerët”.”
 - Aktivitetet sportive janë një mundësi tjetër shoqërimi për nxënës dhe shumë djem takohen si në shkollë ashtu edhe jashtë saj për sporte si futboll (skuadra të përziera dhe të ndara), volejbolli dhe hendboll”.
 - Nxënësit maqedonas gjithashtu thanë se kishin shokë shqiptarë brenda dhe jashtë shkollës. Një nxënës tha se “maqedonasit nuk flasin shqip” dhe një tjetër tha se të gjithë shokët e tij shqiptarë flasin maqedonisht. Një tjetër nxënës tha se ishte kënaqësi shoqërimi gjatë projektit Nansen dhe “të mësohen disa fjalë shqipe, ju mund t'i pyesni ata” ndonjëherë flasim anglisht. Unë gjithashtu flas anglisht sepse nuk flasim gjuhën e njëri-tjetrit”.
 - Ata thanë se prindërit e nganjëherë edhe mësuesit i inkurajojnë ata të shoqërohen; por më së shumti ata vet e bëjnë këtë.”
 - Prindërit thanë se ata mendojnë se kjo do t'i ndihmonte fëmijët të integroheshin me njëri-tjetrin.
 - Një prind tha se “Nansen ka sjellë një ndryshim për disa prindër në shoqërimin ndërmjet komuniteteve.”
 - Mësuesit vunë në dukje se nxënësit e parë Nansen tani janë në klasën VI dhe duan më shumë orë Nansen. “Sa herë që takohen me nxënësit e etnisë “tjetër” në rrugë, ata përqafojnë njëri-tjetrin.”
 - •Mësuesit shohin një ndryshim të madh në atë se si nxënësit sillen me njëri tjetrin pas pjesëmarrjes në Nansen. Ata mendojnë se definitivisht shoqërohen më mirë tani si brenda edhe jashtë shkollës. Ata e shohin përzierjen me etnitë tjera si të natyrshme. Ata punojnë së bashku dhe ndajnë gjërat në klasa tandem (dyshe). Ka pasur një ndryshim të madh nga 5 vite më parë. Gjithkush në shkollë tani e dëshiron atë. Ata e shohin atë si vlerë të shtuar. Fëmijët thonë se janë “krenarë që janë pjesë e Nansenit”

Përgjigjet për aktivitetet e përbashkëta "

- Mësimet dhe aktivitetet e përbashkëta gjatë seancave jashtë programeve mësimore janë shumë pozitive dhe të suksesshme. Mësuesit, nxënësit dhe prindërit theksojnë të gjithë rëndësinë e tyre në jetën e shkollës. Programi ka transformuar mësimdhënien në shkollë, si dhe marrëdhëniet ndërmjet stafit, nxënësve dhe prindërve.
- Fëmijët mësojnë së bashku në grupe të përziera nga mësues tandem, një maqedonas dhe një shqiptar. Ata i mbajnë seancat në të dyja gjuhët dhe përmbajtja përfshin fusha të studimit nga të dyja kulturat.
- Nxënësit janë të përfshirë në aktivitete të ndryshme gjatë seancave jashtëprogramore si drama, përgatitjen e ditëlindjeve me ushqime dhe punime artizanale, duke bërë modele vullkanesh, etj. "
- Një nxënës tha se “ka bërë shokë të rinj sidomos në dramë”, ndërsa një tjetër tha: “Isha e lumtur në projekte të ndryshme - drama ishte argëtuese dhe interesante”. Një tjetër tha "përmirësova Maqedonishten dhe gjithashtu mësova lojëra të reja ". "
- Ata me të vërtetë u kënaqën me ekskursionin Nansen në Shkup, ku vizituan kopshtin zoologjik, planetariumin dhe kinemanë. Disa nxënës në autobus qëndronin veçmas nga njëri-tjetri dhe të tjerët u ulën me shokët maqedonas. Të gjithë arritën të shoqëroheshin me “të tjerët” gjatë udhëtimit. Një nxënës maqedonas tha: “Në autobus mësuesi na uli në çifte maqedonas /shqiptar. Kjo

- është shumë mirë për shoqërim.”
- Me të vërtetë të gjithë nxënësit u kënaqen me aktivitetet interkulturore jashtë-mësimore.
 - Një nxënës i klasës së 6 tha: “Isha shumë i lumtur ... kam bërë gjëra dramatike dhe qesharake dhe gjëra interesante. Ne duhet të kemi Nansen në klasën VI. Më mungon. Unë ende i takoj ata shokët e Nansen maqedonas në sportet jashtë. Në shkollë i shoh ata në fund të ndërrimit.”
 - Një tjetër nxënës i klasës 6 tha: “Ne dëshirojmë që klasat tona të jenë si klasat e Nansenit.”
 - Një tjetër nxënës tha nëse Nansen përfundon “Do të ishte me të vërtetë keq ... Do të isha shumë e mërzitur. Unë nuk do të kisha shokë të ri dhe aktivitete të reja. Unë nuk do ta dija maqedonishten.”
 - Prindërit mendojnë se fëmijët e tyre ishin “më të lumtur dhe shumë të angazhuar gjatë Nansenit ... ata ishin shumë të lumtur për të mësuar diçka krejtësisht të ndryshme së bashku me shokët e tyre”.

Përgjigjet lidhur me gatishmërinë për të mësuar gjuhën dhe kulturën e tjetrit

- Shkolla i njofton nxënësit me historinë dhe kulturën e maqedonasve dhe të shqiptarëve përmes temave të ndryshme si etika, edukimi qytetar dhe festimin i festave tradicionale si Pashkët dhe Bajrami.
- Programi jashtëshkollor i Nansen përfshin në mënyrë specifike shumë aktivitete të cilat promovojnë të dyja kulturat. Gjithashtu, ai realizon programin përmes mësuesve tandem , një i cili flet shqip dhe tjetri që flet maqedonisht gjatë çdo seance. Për shkak se mësuesit tandem (dysh) punojnë me të dyja gjuhët, fëmijët mësojnë diçka nga gjuha e tjetrit duke punuar në grupe maqedonase/shqiptare.
- Një nxënës shqiptar tha se i pëlqente të shkonte në projektin Nansen “të argëtohej dhe të bënte shokë të rinj dhe të kuptonte një gjuhë tjetër.”
- Një nxënës tha se “maqedonasit nuk flasin shqip”, ndërsa një tjetër tha se të gjithë shokët shqiptarë flasin maqedonisht. Një nxënës vuri në dukje se ndonjëherë mësuesi i ndihmon të kuptojnë gjuhën shqipe.
- Asnjë nga nxënësit maqedonas nuk tha se fliste shqip. “Ne nuk mësojmë gjuhën shqipe në shkollë përveçse në Nansen ... ndonjëherë mësuesi ynë na ndihmon t’i kuptojmë shokët tanë shqiptarë”. Disa prej tyre u flasin shokëve shqiptarë në gjuhën angleze.”
- Një nga prindërit tha për vajzën e saj, “ajo filloi të mësonte maqedonishten dhe kishte një përmirësim të madh në gjuhën e saj.”

Përgjigjet lidhur me shpirtin e unitetit (gatishmëria dhe interesi - dygjuhësia dhe gjuha)

- Trajnimi i Nansen ka inkurajuar përdorimin e të dy gjuhëve brenda aktiviteteve interkulturore. Mësuesit tandem e realizojnë komunikimin në të dyja gjuhët gjatë orës mësimore. Ata gjithashtu i inkurajojnë fëmijët në grupet e tyre të përziera që të interesohen për gjuhën e njëri-tjetrit. Tekstet janë në shqip dhe maqedonisht në afishet e vendosura në muret e klasës si dhe në korridore dhe fletët e punës të nxënësve.
- Disa nxënës shqiptarë dhe maqedonas dëshirojnë të shohin ndërrime të përziera sepse atëherë “ne mund të shoqërohemi, mund të gjejmë shokë të rinj dhe të afrohem më shumë me ta. Ndonjëherë ne mund të mësojmë gjëra të reja prej tyre si matematikë ose fjalë të reja” dhe se “do të ishte më mirë në

- klasat e përziera ... një mundësi e mirë për ne për të mësuar.”
- Një nxënëse shqiptare tha: “shoqja ime më e mirë më ka mësuar fjalë në maqedonisht dhe unë i mësova asaj fjalë në shqip. Ajo është shoqja ime më e mirë në të gjitha mënyrat.” Një nxënëse tjetër tha: “Një djalë më dëgjoi të flisja maqedonisht dhe ai mendoi se isha maqedonase Kam fituar miqësi të re.”
 - Një nga prindërit tha: “Një nga gjërat më të mira është se vajza ime filloi të mësojë maqedonishten”

Përgjigjet për intolerancën dhe armiqësinë

- Që nga inkuadrimi i modelit Nansen, drejtori mendon se ka më pak konflikte midis nxënësve maqedonas dhe shqiptarë.
- Mësuesit shohin një ndryshim të madh në mënyrën se si sillen fëmijët në krahasim me 5 vite më parë, përpara se të niste projekti Nansen. Nxënësit tani komunikojnë me njëri-tjetrin më mirë dhe ndajnë gjësende në shkollë dhe atmosfera është shumë më pozitive.
- Një nxënës maqedonas tha se ishte mirë që ishte përfshirë në projektin Nansen “Kryesisht për të bërë shokë, për të biseduar, për të mos qenë racist. Edhe pse nuk e njohim gjuhën shqipe, është një ide e mirë. Gjithashtu, Nansen ka resurse të mira.”
- Prindërit ndjejnë se fëmijët janë më të lumtur dhe shumë më të angazhuar në shkollë si pjesë e Nansen. Një prind tha se “disa situata konflikti u zgjidhën shumë lehtë dhe Nansen ndihmoi shumë”. Atmosfera e shkollës ishte shumë më e mirë dhe pengesat tashmë ishin zhdukur”.
- Një prind tha “për shkak të Nansen prindërit kanë më pak paragjykitime.”

Përgjigjet lidhur me komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet mësuesve

- Modeli Nansen për arsim interkulturor ka ndikuar në jetën e shkollës mënyra të ndryshme sipas drejtorit dhe drejtorisë së shkollës. Mësuesit kanë zhvilluar marrëdhënie më të mira. Mësuesit zgjedhin partnerin e tyre tandem dhe ata punojnë mirë së bashku.
- Mësuesit vetë mendojnë se modeli Nansen padyshim që e ka ndryshuar punën e tyre profesionale me kolegët e tyre “të tjerë”. Para Nansenit, ata vetëm përshëndetnin njëri-tjetrin, por jo edhe të komunikonin shumë. Me kolegun e tyre tandem, ata shkëmbejnë ide dhe janë shumë më të afërt. Ata madje shoqërohen edhe jashtë shkollës. Ata punojnë së bashku në mënyrë profesionale dhe pozitive gjatë aktiviteteve jashtëshkollore pasi zbuluan se mund të bëjnë më shumë dhe të jenë më kreative.
- Ata mendojnë se trajnimi Nansen është i cilësisë shumë të lartë dhe shumë i dobishëm në ngritjen e nivelit të profesionalizmit të tyre. Cilësia e lartë, punimet shumëgjyreshe në korridoret dhe në klasën e Nansenit janë rezultat i trajnimit.”
- Ata janë gjithashtu të pajisur më mirë në drejtim të teknologjisë, si laptopë, projektorë, laminatorë dhe materiale kreative të artit. Kjo iu lejon atyre të mësojnë në një mënyrë më interesante, duke nxitur të mësuarit aktiv për nxënësit që u pëlqen ajo”.
- Një mësues tandem thotë: “Nansen beson tek ne dhe ne besojmë në Nansen ... suksesi më i madh është se të gjitha njohuritë e trajnimit mund të vihen në praktikë dhe të pasqyrohen në sjelljen e nxënësve dhe në sjelljen tonë.”
- Tandemët e mësuesve janë shumë krenarë për trajnimin e Nansenit dhe punën

që bëjnë tani me nxënësit në shkollë. Që nga shtatori ka pasur shumë klasa të hapura dhe vizitorë. “Ne e vlerësojmë dhe jemi shumë krenarë që shqiptarë dhe serbë nga Kosova na vizitojnë ... kështu që fjala është përhapur se diçka e mirë po ndodh.”

- Drejtori tregon shumë respekt për mësuesit tandem, gjë të cilët ata e vlerësojnë me të vërtetë.

Përgjigjet lidhur me interkulturalizmin në procesin mësimor

- Trajnimi i modelit Nansen ka rritur gatishmërinë dhe aftësinë e mësuesve për të realizuar përmbajtjen dhe aktivitetet interkulturore. Mësimdhënësit raportojnë se trajnimi është shumë i mirë, interesant dhe i dobishëm dhe se ata përpiqen të zbatojnë programin. “Kemi pasur shumë mbështetje të mirë.” Njerëzit tjerë, prindërit dhe miqtë mendojnë se kjo punë është e dobishme në afat të gjatë kohor.
- Një mësuese tha se prezantimi i trajnimit Nansen mbi dialogun interkulturore i ka ndihmuar asaj të merrte këshilla dhe udhëzime për ta zbatuar atë në klasë. Ai gjithashtu e ka ngritur nivelin e saj të të kuptuarit.”
- Nansen krijoi një fjalor maqedonisht-shqip për nxënësit, si në forme të shtypur, po ashtu edhe në internet (onlajn).
- Mësuesit thonë se tani materialet interkulturore janë më mirë: “Në të kaluarën kishte vetëm libra. Tani ne praktikisht e përdorim atë. “Shembujt e dhënë ishin shpalosur në diskutimin për “Paqen dhe Tolerancën”, kur klasa filloi të fliste për Maqedoninë, më pas kaloi tek diskutimi mbi Shqipërinë, pastaj mbi Serbinë, dhe pastaj për një temë tjetër”.
- Njëri prej prindërve shprehu lëvdata të mëdha për mësuesit tandem – “ata japin energji të madhe”.

Përgjigjet lidhur me përfshirjen e prindërve në aktivitetet interkulturore të shkollave

- Projekti Nansen inkurajon përfshirjen e prindërve në shkollë. Ekipi i Nansen fton prindërit në një prezantim rreth programit dhe prindërve u jepet mundësi për të parë se çfarë programi ka para se fëmijët e tyre të ftohen të regjistrohen zyrtarisht për aktivitete jashtëshkollore. Drejtori shpjegoi se prindërit nënshkruajnë një marrëveshje formale se ata janë të gatshëm që fëmijët e tyre të angazhohen në këtë punë.
- Prindërit ishin plotësisht të vetëdijshëm për modelin Nansen për arsimin interkulturore, sepse atyre iu dha një prezantim nga stafi i Nansenit dhe më pas i kishin regjistruar fëmijët e tyre në projekt. Ata e falënderuan Nansen për përfshirjen e tyre dhe për materialet që nuk i kishin pasur në të kaluarën. Atyre u kishte pëlqyer se si projekti ishte organizuar dhe si ishin përfshirë prindërit.
- Prindërit u përgjigjën duke ndihmuar në rregullimin e klasave duke pikturuar dhe dekoruar dhe organizuar materialet. Kjo i solli mësuesit dhe prindërit më afër njëri-tjetrit. Drejtori vuri në dukje se “pa mbështetjen e prindërve, kjo është diçka që nuk do të mund të ndodhë”.
- Drejtori dhe ekipi menaxhues pohojnë se prindërit janë më të angazhuar në shkollë dhe ka më pak probleme me nxënësit.
- Prindërit dhe bashkësia më e gjerë ftohen për të kontribuar në mësim dhe mësimdhënie në shkollë duke dhënë prezantime në tema si riciklimi, siguria në trafik dhe ushqimi i shëndetshëm.
- Mësuesit theksuan se punëtoritë e Nansenit për prindërit ndihmuan në krijimin e kontakteve të mira midis prindërve dhe mësuesve. Ata tani e njohin mirë

njëri-tjetrin dhe komunikimi dhe bashkëpunimi është shumë i mirë. Prindërit ishin shumë pozitivë në lidhje me punëtoritë dhe kërkuan më shumë seminare të tilla.

- Një mësues tha se kur u shfaq Nansen, disa ishin “për” dhe disa “kundër”. Gjëja kryesore ishte të përfshiheshin prindërit. “Ne nuk kemi probleme me fëmijët, vetëm prindërit.” Tani nxënësit dhe prindërit duan të marrin pjesë në Nansen dhe prindërit nuk do të kishin një problem me klasa të përziera”.
- Një prind tha: “Është kënaqësi të jesh pjesë e këtij projekti ... është shumë mirë sidomos me komunikimin që ata (Nansen) kanë me shqiptarët dhe maqedonasit”.
- Një prind i ri për Nansen donte të shprehte mirënjohje për projektin: “Është pozitive për prindërit dhe fëmijët dhe madje edhe prindërit mund të shoqërohen. Ne mund të përfshihemi. Nansen ndihmon shumë në lidhje me shoqërimin”.
- Prindërit ishin të kënaqur që morën pjesë në vlerësim dhe ishin shumë pozitivë për Modelin Nansen për arsim interkulturore në Shkollën “Goce Dellçev”.
- Një prind tha se i pëlqente organizimi: “Më pëlqen që prindërit ishin të përfshirë për... Krishtlindjet, festat, projektet”.

Përgjigje për bashkëpunimin me shërbimin pedagogjik dhe psikologjik në shkollë

- Psikologu i shkollës aktualisht është duke ndjekur trajnime të modelit Nansen.

Përgjigjet lidhur me dimensionin interkulturore të shkollës

- Sipas mësimdhënësve ikonografia në shkollë ka ndryshuar gjithsesi që kur filloi implementimi i modelit Nansen. Mësimet përgatiten në të dy gjuhët - maqedonisht dhe shqip. Të dyja gjuhët pasqyrohen në një faqe për fletët e punës, afishe në mure dhe në klasat dhe korridoret e Nansenit.
- Nxënësit njoftohen me historinë dhe kulturën e Maqedonisë përmes lëndës së etikës dhe religjionit dhe nga aktivitetet jashtëshkollore, p.sh. të mësuarit për martesat e ndryshme etnike, kremtimi i festive të ndryshme së bashku.”
- Një nxënës foli për të bërë aktivitete të reja të Nansenit për Shqipërinë dhe flamujt dhe gjithçka për Maqedoninë – “aktivitet i përsosur ... dhe këtë vit mësuam për stolitë e çmuara të nënave dhe gjysheve tona dhe u kënaqem shumë së bashku”.
- Ka kremtime të përbashkëta për festat fetare p.sh. Bajrami dhe Pashkët kur fëmijët sjellin ushqime tradicionale nga shtëpia dhe mësuesit dhe fëmijët i hanë së bashku.
- Një prind tha: “Të gjithë fëmijët duhet të përfshihen në të [Nansen] ... Është i shkëlqyer për të gjithë shoqërinë. Në të kaluarën, kishim integrim midis fqinjëve tanë. Ky projekt ndihmon pak më shumë me integrimin mes fëmijëve tanë”.
- Shumica e prindërve mendojnë se Nansen duhet të shtrihet në të gjithë shkollën nga klasa I deri në klasën IX.
- Një prind (mësues i kopshtit) tha: “Duhet të fillojë edhe para klasës 1.”
- Të gjithë prindërit u pajtuan me prindin i cili tha “Bëjeni Nansen të detyrueshëm në të GJITHA shkollat, duke përfshirë edhe shkollat e mesme”.

PËRMBLEDHJA E FAKTEVE

Impakti, ndikimi dhe përfitimet e modelit Nansen për drejtorinë e shkollës, nxënësit, mësuesit dhe prindërit në lidhje me ndryshimet në qëndrimet, vlerat dhe sjelljet në fushën e interkulturalizmit.

1. Udhëheqësia

“Nëse do të më pyesni se cila ishte gjëja më e mirë që kam bërë, do të thosha modeli Nansen për Arsimit të Integruar” ishte mesazhi kryesor i drejtorit. Në lidhje me ndikimin që Nansen ka pasur mbi shkollën, drejtori dhe ekipi drejtues janë shumë të hapur për faktin se skepticizmi i tyre fillestar për futjen e modelit Nansen në shkollën fillore “Goce Dellçev” ka ndryshuar në një vlerësim të thellë mirënjohës për përfitimet nga Nansen në kuptimin e afrimit të ndërsjellë të fëmijëve, prindërve dhe mësuesve maqedonas dhe shqiptarë, duke krijuar një atmosferë tjetër më pozitive në shkollë. Drejtori përshkroi problemet dhe vështirësitë në fillim. Në të kaluarën, shumë projekte erdhën në shkollë dhe më pas përfunduan. Me Nansen ai tani ndjehet se ka një bashkëpunim shumë të suksesshëm, që ai mendon se do të jetë afatgjatë. Ai gjithashtu ka parë se sa shpejt mësuesit e pranuan projektin, përkundër punës shtesë dhe pa pagesë që duhej bërë. Mësuesit i raportuan atij se fëmijët ishin aq të interesuar sa që dëshironin të ndiqnin më shumë aktivitete jashtëshkollore. Mësuesit vetë ishin të motivuar që të qëndronin më gjatë në punë dhe i gjithë qëndrimi i tyre ndaj shkollës ndryshoi dhe u bë më pozitiv. Sjellja e nxënësve është përmirësuar shumë dhe duket se ka më pak tension mes nxënësve maqedonas dhe atyre shqiptarë. Anëtarët e ekipit menaxhues e vlerësuan rolin e rëndësishëm të drejtorit dhe zëvendësit në promovimin dhe mbështetjen e projektit, duke ndihmuar kështu për ta bërë atë një sukses kaq të madh. Kishte një ndjenjë krenarie që shkolla e tyre ishte e para që filloi të zbatonte Nansen modelin dhe se tani shkolla nga e gjithë Maqedonia po vijnë për ta parë atë në praktikë.

2. Shoqërimi, mostoleranca dhe armiqësia

Ka pasur shumë përgjigje pozitive rreth shoqërimit që nga implementimi i konceptit Nansen. Të gjithë nxënësit e intervistuar duket se kanë përfituar nga lloji i kontaktit gjatë aktiviteteve të tyre jashtëmësimore gjë që ka ndihmuar në shoqërimin e tyre ndëretnik si brenda ashtu edhe jashtë shkollës. Para projektit, prindërit thanë se nxënësit nuk shoqëroheshin brenda shkolle, por vetëm jashtë saj. Prindërit gjithashtu menduan se projekti do të ndihmonte që fëmijët të integrohen me njëri-tjetrin. Ekipi i menaxhmentit gjithashtu mendon se nxënësit nuk shoqëroheshin mjaftueshëm në shkollë para Nansenit. Mësuesit shohin një ndryshim të madh në atë se si nxënësit sillen me njëri-tjetrin pasi kanë marrë pjesë në Nansen. Ata mendojnë se nxënësit definitivisht shoqërohen më mirë tani brenda dhe jashtë shkollës. Ekipi i menaxhmentit të shkollës mendojnë se nxënësit e shohin përzjerjen me etni të tjera si të natyrshme. Ata punojnë së bashku në klasa tandem dhe ndajnë me njëri-tjetrin. Sipas mësuesve ky është një ndryshim i madh nga disa vjet më parë, para fillimit me Nansen. Fëmijët thonë se janë krenarë që janë pjesë e projektit Nansenit.

Hulumtimet e mëparshme sugjerojnë që prindërit, mësuesit dhe nxënësit më të vjetër maqedonas mendonin se kishte konflikte të shpeshta dhe tensione për shkak të mjedisit dhe mediave. Fëmijët e vegjël dhe menaxhmenti thanë se nuk kishte armiqësi por

vetëm konflikte të rralla verbale. Nxënësit më të vjetër thanë se armiqësia ekzistonte në formën e kërcënimeve, ofendimeve dhe rrahjeve. Që nga fillimi i Nansenit, drejtori mendon se ka më pak konflikt midis nxënësve maqedonas dhe atyre shqiptarë. Një nxënës maqedonas mendon se Nansen ishte një ide e mirë sepse u ndihmon njerëzve të mos jenë racist. Një nga prindërit mendon se Nansen ka ndihmuar shumë dhe se disa situata konflikti u zgjidhen shumë lehtë falë tij.

3. Aktivitete të përbashkëta

Hulumtimi i mëparshëm tregon se shumica e prindërve dhe mësuesve thanë se në atë kohë nxënësit nuk kishin aktivitete të përbashkëta. Nxënësit bënë vetëm aktivitete të përbashkëta gjatë sportit dhe garave. Aktivitetet e përbashkëta sportive janë të rëndësishme për t'i afruar fëmijët me kulturat e ndryshme. Që nga Nansen, rritja e mundësive për mësim të përbashkëta dhe aktivitete jashtëshkollore ka qenë shumë të suksesshme dhe pozitive. Gjithë nxënësit, prindërit dhe mësuesit mendojnë se aktivitetet e Nansen kanë qenë një ndikim i rëndësishëm në jetën e shkollës në kuptimin e përvojave interkulturore dhe ndëretnike. Mësuesit tandem, një mësues shqiptar, një mësues maqedonas, modeli për bashkëpunim dhe respekt për “tjetrit” janë aplikuar gjatë seancave jashtëshkollore. Ata i mbajnë seancat në të dy gjuhët dhe përmbajtja përfshin fusha të studimit nga të dyja kulturat. Fëmijët mësohen së bashku në grupe të përziera dhe inkurajohen të shkëmbejnë idetë, sugjerimet dhe gjuhët. Fillimisht aktivitetet jashtëshkollore organizoheshin nga dy deri në tre herë në javë, por që nga fillimi i vitit shkollor 2017/18 kjo duhej të ishte reduktuar në një aktivitet në javë, për shkak të rritjes së numrit të detyrueshëm të orëve. Shtimi i lëndëve shtesë të detyrueshme gjatë disa viteve të fundit ka rezultuar që të ketë më pak kohë për aktivitetet jashtëshkollore. Fëmijët u gëzuan shumë me ekskursionin e organizuar me autobus në Shkup ku ata vizituan kopshtin zoologjik, planetariumin dhe kinemanë. Ata ishin në një autobus me miqtë e tyre Nansen, ndonjëherë pranë njëri-tjetrit, ndonjëherë në të njëjtin rresht, ata u kënaqen duke kënduar gjatë udhëtimit. Prindërit mendojnë se aktivitetet e përbashkëta interkulturore bënë një ndryshim të madh në edukimin e fëmijëve të tyre. Ata ndjejnë se fëmijët e tyre ishin më të lumtur dhe më të angazhuar në shkollë gjatë Nansenit. Ata thanë se fëmijët ishin të lumtur që po mësonin diçka krejtësisht të ndryshme së bashku me shokët e tyre.

4. Gatishmëria dhe interesi për të mësuar gjuhën dhe kulturën e tjetrit

Hulumtimi i modelit non-Nansen (Jo Nansen) tregoi se shumica e nxënësve mendonin se mësonin mjaftueshëm për historinë dhe kulturën e të tjerëve. Prindërit më pak mendonin kështu. Përfitimi i të mësuarit së bashku në modelin Nansen rreth historisë dhe kulturës së tjerëve është mundësia për të afruar fëmijët dhe të rriturit e të dy etnive dhe kjo krijon një dinamikë të re në drejtim të ndërgjegjësimit për “tjetrit”. Gjithashtu sjell njohuri dhe përvojë shtesë në lidhje me kulturat e ndryshme për t’u mësuar. Prindërit mendojnë se aktivitetet jashtëshkollore inkurajuan gjithashtu fëmijët që të mësonin gjuhën e tjetrit. Nxënësit maqedonas në përgjithësi nuk flasin shqip, sepse nuk e mësojnë atë në shkollë. Megjithatë, në orët jashtëprogramore, ata përpiqen të mësojnë disa fjalë nga shokët e tyre shqiptarë. Disa nga nxënësit shqiptarë e kanë parë si shumë të dobishme të mësuarit e gjuhës nga shokët e tyre tjerë. Ata gjithashtu nganjëherë përdorin gjuhën angleze për të komunikuar me njëri-tjetrit sepse të gjithë mësojnë anglisht nga klasa e parë.

Në hulumtimet e mëparshme si mësuesit ashtu dhe ekipit menaxhues janë shprehur

të kënaqur me shkollat dygjuhëshe, edhe pse ata konsiderojnë se një shkollë etnikisht e përzier ishte një sfidë e madhe. Prindërit dhe fëmijët mendojnë se duhej të kishte më shumë aktivitete të përbashkëta për nxënësit dhe mësuesit. Të gjithë të anketuarit ranë dakord se kishte nevojë për të përmirësuar dialogun midis nxënësve. Trajnimi i modelit Nansen ka inkurajuar përdorimin e të dy gjuhëve në aktivitetet jashtë programore interkulturore. Mësuesit tandem modelojnë komunikimin në të dyja gjuhët dhe inkurajojnë fëmijët që të interesohen për gjuhën e njëri-tjetrit. Tekstet janë në shqip dhe maqedonisht në afishe në muret e klasës dhe në korridoret jashtë klasave Nansen. Disa nxënës shqiptarë dhe maqedonas dëshirojnë të shohin ndërrime të përziera sepse mendojnë se mund të shoqërohen më mirë me “të tjerët” dhe të bëjnë shokë të rinj. Prindërit ishin gjithashtu në favor të ndërrimeve të përziera.

5. Komunikimi dhe bashkëpunimi mes mësimeve dhe gjatë mësimit

Hulumtimi i vitit të kaluar tregoi se mësuesit donin planifikimin e përbashkët të mësimeve dhe aktiviteteve të tjera të programeve mësimore (kurrikulare) dhe programeve jashtë mësimore (ekstra-kurrikulare). Në fakt, kjo është pikërisht ajo mundësia që modeli Nansen u dha atyre. Mësuesit tandem planifikojnë së bashku orët e tyre Nansen. Ata mendojnë se kjo i lejon ata të shkëmbejnë ide dhe punojnë më kreativisht. Mësuesit në mënyrë të qartë mendojnë se Nansen ka ndryshuar patjetër se si ata punojnë në mënyrë profesionale me kolegët e tyre 'të tjerë'. Para Nansenit ata vetëm përshëndetnin njëri-tjetrin, por në të vërtetë nuk komunikojnë shumë me njëri-tjetrin. Trajnimi i Nansen ka ndryshuar mënyrën e tyre të mësimit. Pedagogjia e tyre është më pak didaktike dhe më e fokusuar në të mësuarit aktiv gjatë aktiviteteve të tyre interkulturore jashtë-kurrikulare. Mësimi aktiv përfshin nxënësit fizikisht, kognitivisht dhe emocionalisht. Si mësuesit ashtu dhe nxënësit janë përgjigjur shumë mirë ndaj kësaj qasjeje, e cila në vetvete është thelbësore për nxitjen e arsimit interkulturore. Mësuesit mendojnë se trajnimi Nansen është i cilësisë shumë të lartë dhe ka qenë shumë i dobishëm në rritjen e nivelit të profesionalizmit. Ai ka rritur gatishmërinë dhe aftësinë e mësuesve për të realizuar përmbajtje interkulturore dhe ndëretnike. Trajnimi i Nansenit mbi dialogun interkulturore i dha një mësuesi njohuri dhe ide të nevojshme për të provuar të njëjtën gjë në klasën e tyre. Shfaqjet informative dhe shumëgjyreshme në klasat dhe korridoret e Nansenit janë rezultat i trajnimit dhe resurseve të siguruar nga Nansen. Ato janë gjithashtu të pajisur më mirë përmes Nansen në drejtim të teknologjisë si laptopë, projektorë, laminatorë dhe materiale për art kreativ. Mësuesit tandem gjithashtu mendojnë se materialet interkulturore janë më mirë tani pasi që po realizohen praktikisht tani, jo vetëm duke i marrë nga librat. Moduli “Paqe dhe Tolerancë”, gjatë të cilit u diskutua për Maqedoninë, Shqipërinë dhe Serbinë, u përdor si një shembull i mirë në këtë kontekst. Prindërit ishin shumë të zellshëm në lavdërimin drejtuar mësuesve të përfshirë në modelin Nansen dhe thanë se mësuesit kishin energji të madhe. Prindërit thanë se fëmijët ishin më të lumtur në ditët që kishin një seancë Nansen. Ata janë më të angazhuar, mësojnë diçka të ndryshme dhe bëjnë shokë të rinj.”

6. Përfshirja e prindërve në aktivitetet interkulturore shkollore

Hulumtimi i vitit 2017 zbuloi se kishte shumë pak përfshirje prindërore në aktivitetet interkulturore të shkollave. Ata ishin përfshirë ndonjëherë në Këshillin e Prindërve dhe në aktivitete të përbashkëta të projektit. Përfshirja e prindërve është e mirëpritur dhe

shihet nga udhëheqja e shkollës si vendimtare në zbatimin e Modelit Nansen. Projekti Nansen ka rritur me të vërtetë përfshirjen e prindërve në shkollë në aktivitetet interkulturore. Nansen inkurajon përfshirjen e prindërve dhe prindërit ishin të kënaqur që u ftuan në një prezantim rreth programit. Më pas ata patën mundësinë për t'i regjistruar fëmijët e tyre formalisht në programin e aktiviteteve jashtëshkollore. Prindërit ishin shumë entuziastë për projektin Nansen dhe ishin shumë të kënaqur që patën mundësinë të ndihmojnë për të pikturuar, dekoruar dhe rregulluar klasat. Kjo i afrooi prindërit dhe mësuesit më afër njëri-tjetrit. Një prind i ri falënderoi për projektin Nansen dhe tha se ai ishte i dobishëm për prindërit dhe fëmijët dhe se edhe prindërit mund të shoqëroheshin përmes tij. Prindërit e tjerë donin të falënderonin Nansen për përfshirjen e tyre dhe për furnizimin e materialeve që shkolla nuk i kishte në të kaluarën. Mësuesit thanë se punëtoritë Nansen për prindërit me të vërtetë kanë ndihmuar në krijimin e kontakteve të mira midis prindërve dhe mësuesve, ata tani e njohin mirë njëri-tjetrin dhe të dy mendojnë se komunikimi është shumë i mirë. Prindërit mendojnë se punëtoritë ishin shumë të mira dhe thanë se do të donin të kishin më shumë prej tyre. Prindërit shfaqen një interes të madh në ndërrimet e përziera duke folur për përfitimet e këtyre në drejtim të integritit më të mirë të nxënësve.

7. Dimensioni interkulturore

Hulumtimi i vitit 2017 tregoi se drejtorja, mësuesit dhe prindërit mendonin se shkolla kishte dimension të mjaftueshëm interkulturore; por disa tjerë mendonin se mund të ishte edhe më mirë. Aktualisht nuk ka shumë ikonografi të shfaqur në shkollë, përveç në klasat dhe korridoret e modelit Nansen. Ikonografia në këto zona është e mbushur me shembuj ndërkulturore të komuniteteve të ndryshme. Mësuesit tandem përgatisin dhe japin aktivitete mësimore në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Listat e punës për studentët që punojnë në grupe të përziera përgatiten në të dyja gjuhët, siç janë shumë posterë në muret e korridoreve. Nxënësit njihen me historinë dhe kulturën si pjesë e kurrikulës normale të shkollës. Nansen e zhvillon këtë përmes mësuesve tandem, duke krijuar mënyra kreative për realizimin e këtij kurrikuli me fëmijët që janë më të angazhuar me metodat e tyre aktive të mësimdhënies. Ilustrimet e këtij lloji të të mësuarit interkulturore përdoren pastaj për të përmirësuar të mësuarit dhe për të festuar diversitetin brenda komunitetit të shkollës. Festimet e përbashkëta bëhen për të shënuar ngjarje fetare si Pashkët dhe Bajramin ku fëmijët dhe prindërit bashkohen me stafin në këto festime në shkollë. Një prind u shpreh se të gjithë fëmijët duhet të përfshihen në projektin Nansen sepse është i shkëlqyer për të gjithë shoqërinë si dhe ndihmon në integrimin e fëmijëve. Një nxënës i përfshirë në një aktivitet të caktuar jashtëmësor që përfshinte flamuj shqiptarë dhe maqedonas deklaroi se ky ishte një "aktivitet i përsosur".

PËRFUNDIM

Ekzistojnë shumë fakte dhe dëshmi personale që tregojnë se modeli Nansen për arsim të integruar ka pasur ndikim dhe impakt të madh, veçanërisht në fushën e arsimit ndëretnik dhe interkulturore, mbi vlerat, qëndrimet, dhe sjelljen e nxënësve, mësuesve dhe prindërve të shkollës fillore “Goce Dellçev” që është e përfshirë në projekt.

Përmes tij, shkollat gjithashtu kanë përfituar nga trajnimet, sigurimi i resurseve dhe mbështetjes së vazhdueshme. Ky projekt ka qenë transformues në aspektin e trajnimit të mësuesve dhe në inkorporimin e metodave bashkëkohore të të mësuarit aktiv, me një fokus të veçantë në mënyrat për të integruar në mënyrë efektive konceptet interkulturore në kurrikulë, duke rritur kështu rëndësinë e saj për shoqërinë multietnike në Maqedoni. Gjithë projekti në të vërtetë mund të shihet si një mjet për përmirësimin e shkollës duke marrë parasysh efektin e tij në të gjithë ambientin e shkollës. Ai është gjithashtu një model i shkëlqyer për shkollat tjera, veçanërisht ato në shoqëritë multietnike dhe multikulturore, të cilat mund të mësojnë prej tij.

Çështje për shqyrtim të mëtejshëm

- roli i punës së rëndësishme interkulturore që Nansen po implementon, ndoshta duhet të konsiderohet si një pjesë thelbësore e kurrikulës, nëse rezultati do të vazhdojë të jetë efektiv.
- qëndrueshmëria - implikime të mëdha për stafin e Nansenit në drejtim të trajnimit dhe sigurimit të burimeve dhe mbështetjes.
- rëndësia jetike e trajnimit të drejtorit dhe ekipit udhëheqës të shkollës
- pjesëmarrja e gjithë shkollës në trajnim dhe mundësi për pjesëmarrje
- rëndësia e angazhimit të nxënësve më të vjetër në program
- punëtori të vazhdueshme për prindërit
- shqyrtimi i ndërrimeve fikse në shkollë
- vëzhgimi i vazhdueshëm i praktikave të mira në arsimin interkulturore në Maqedoni dhe jashtë vendit
- mirënjohje dhe mbështetje për projektin si një mjet kyç në ndërtimin e marrëdhënieve interaktive dhe harmonike në komunitet